



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DECENTRALIZIM DHE
KOMUNITETE**

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Mujo –Shtator 2007

Dështimi për respektimin e parimit të ligjshmërisë paraqet shkelje të ligjit vendor dhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) është i shqetësuar që gjykatat në Kosovë kanë dështuar në respektimin e parimit të ligjshmërisë duke ndjekur penalisht personat për krime që nuk kanë përbërë vepër penale në kohën kur është raportuar se janë kryer këto vepra, apo duke shqiptuar sanksione që tejkalojnë maksimumin e paraparë me ligj.

Parimi i ligjshmërisë (“*nullun crimen, nullapoena sine lege*”) është një parim fundamental juridik i cili ka për qëllim mbrojtjen e individit ndaj shqiptimit arbitrar të dënimeve nga ana e shtetit. Ky parim është gjerësisht i pranuar si me konventat për të drejtat e njeriut¹ ashtu dhe me ligjin vendor².

Pjesa e parë e parimit *nullum crimen sine lege*, ndalon dënimin e personit për veprën e cila në kohën e kryerjes nuk përbënte vepër penale. Prandaj, dispozita penale juridike nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive. Pjesa e dytë *nulla poena sine lege* mbron kryesisht e veprës nga marrja e dënimit më të rëndë se nga ajo që është e paraparë me ligj.

Megjithatë, OSBE ka monitoruar disa raste ku gjykatat e Kosovës kanë shkelë te dy aspektet e parimit të ligjshmërisë.

Me 7 nëntor 2006, në një rast pran një Gjykate të Qarkut, gjykata konfirmoi aktakuzën kundër një të pandehuri për veprën penale të trafikimit më qenie njerëzore, sipas nenit 139(3) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), një vepër penale serioze e cila rezultoi me dënim nga 7 deri me 20 vjet burgim. Megjithatë, veprimet e supozuara që përbënin trafikimin kishin ndodhur gjatë vitit 1999, dy vite para se trafikimi të jetë klasifikuar si vepër e veçantë penale në sistemin ligjor të Kosovës,³ dhe pesë vite para hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore në të cilën ishte bazuar aktakuza⁴.

Në dy gjykime⁵ pranë një Gjykate Komunale, të dy gjykimet e mbajtura me 16 gusht 2007, gjykata shpalli fajtor dy të pandehur për veprën penale kalim ilegal i kufirit⁶ dhe dënoi secilin me gjobë nga 900 euro.⁷ Ligji përcaktoi dënimin me 250 euro për këtë vepër.

Në rastin e parë, gjykata aplikoi dispozitat ligjore në mënyrë retroaktive. Në rastin e dytë, shqiptoi dënim më të rëndë se sa që e lejon ligji.⁸ Në të dyja rastet, gjykata shkeli ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat kodifikojnë parimin e ligjshmërisë.

¹ Shih neni 15(1) i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), dhe neni 7(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), Shih gjithashtu Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), *Kokkinakis v. Greqisë*, aktgjykimi, 25 maj 1993 paragrafi 52.

² Shih neni 1 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), i nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2003/25 Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës 6 korrik 2003.

³ Shih Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 mbi Ndalimin e trafikimit me persona në Kosovë, 12 janar 2001.

⁴ KPPK hyri në fuqi me 6 prill 2004.

⁵ Procedura është zhvilluar sipas Nenit 476 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK).

⁶ Neni 114(1), KPPK

⁷ Shënim, ekzekutimi i dënimit është suspenduar sipas Nenit 43 të KPPK.

⁸ Shënim, në të dyja rastet avokatët mbrojtës paraqitën ankesë këtyre aktgjykimeve mbi bazë të shkeljes së Nenit 1 dhe 2 të KPPK.

Për këtë arsye, OSBE rekomandon që:

- Prokurorët nuk duhet t'i ndjekin penalisht personat dhe gjyqtarët nuk duhet t'i dënojnë të pandehurit për veprat të cilat nuk kanë përbërë vepër penale në kohën e supozuar të kryerjes.
- Gjyqtarët duhet të shqiptojnë dënimet që janë të lejueshme sipas ligjit.
- Kur një gjykatë dënon një të pandehur për një vepër penale apo dënim që nuk parashihet me ligj, avokati i tij apo saj duhet të atakoj aktgjykimin në bazë të shkeljes së nenit 1 dhe 2 të KPPK.

Vonesat në ekzekutimin e vendimeve të përfundimtare të gjykatave paraqesin shkelje të ligjit vendor dhe të drejtën për një gjykim korrekt

OSBE është e shqetësuar që disa gjykata dështojnë të veprojnë menjëherë pas propozimit të palëve për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, duke shkelur kështu të drejtën për gjykim korrekt.

Implementimi efektiv i aktvendimeve të gjykatave nënkuptohet në kuadrin e garancive për të drejtën për gjykim korrekt, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Për më tepër Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) mban qëndrimin se e drejta për qasje në gjykatë “do të ishte iluzore” (...) nëse sistemi ligjor vendor lejon që një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe detyruet të mos prodhojë efekte në dëm të njërës palë.”⁹ Për më tepër, sipas nenit 6 të KEDNj, secili ka të drejtë për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kjo periudhë përfshin zbatimin e procedurës.

Sipas ligjit vendorë të aplikueshëm, Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore (LPP) gjykata është e obliguar në procedurën e përmbartimit që të vazhdojë menjëherë pas propozimit të kreditorit.¹⁰

Përkundër këtyre dispozitave, OSBE ka monitoruar disa raste kur gjykata nuk ka vepruar menjëherë pas propozimit të kreditorit, duke bërë kështu shkelje të ligjit vendor dhe duke ndikuar në të drejtën e palës për gjykim korrekt. Rastet si në vijim shërbejnë si shembull:

Në një rast pranë një Gjykate Komunale, gjykata ka vendosur në aktgjykimin e datës 13 shtator 2001 që të kërkojë nga i padituri ta lirojë pasurinë e kontestuar dhe t'i dorëzojë në posedim paditësit brenda 15 ditëve. Gjykata e Qarkut, e ka vërtetuar këtë aktgjykim më 4 dhjetor 2001. Mirëpo, pasi paditësi kishte kërkuar lirimin nga objekti më 21 dhjetor 2001,¹¹ referenti për ekzekutim vetëm pjesërisht e ka ekzekutuar aktgjykimin më 21 qershor 2002, dhe e ka dëbuar të paditurin nga një pjesë pasurisë. Rrjedhimisht, më 29 korrik 2003, paditësi ka paraqitur edhe një kërkesë për lirimin e të paditurit nga i gjithë lokali.¹² Mirëpo, gjykata nuk ka arritur të ndërmer asnjë veprim deri më 24 prill 2007 kur paditësi e ka paraqitur edhe një kërkesë për ekzekutim. Momentalisht, procedura e ekzekutimit është në pritje e sipër dhe aktgjykimi deri më tani është ekzekutuar vetëm pjesërisht.¹³

⁹ Shih *Hornsbz v. Greqisë*, aktgjykimi i GjEDNj 19 mars 1997 paragrafi 40.

¹⁰ Neni 2(1) dhe 10(1), Ligji mbi Procedurën Përmbartimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë., 21 prill 1978 nr. 20/78

¹¹ Gjykata e ka pranuar kërkesën për ekzekutim më 18 janar 2002.

¹² Gjykata e ka pranuar kërkesën për ekzekutim më 30 korrik 2003.

¹³ Më 11 qershor 2007, gjykata e ka obliguar paditësin që ta plotësojë kërkesën për ekzekutim. Pas parashtrësës së paditësit më 18 qershor 2007, gjykata e ka refuzuar kërkesën. Paditësi është ankuar kundër

Në një rast tjetër para një Gjykate Komunale, në aktgjykimin e datës 9 shkurt 2005 gjykata ka kërkuar nga i padituri që t'i paguaj dëmet në formë të kompensimit. Gjykata e Qarkut e ka vërtetuar aktgjykimin më 12 korrik 2006, dhe më 12 qershor 2006 paditësi ka kërkuar përmbarimin e aktgjykimit nga ana e një Gjykate Komunale. Mirëpo, vetëm pas gjashtë muajsh më vonë më 2 mars 2007, gjykata e kishte marrë vendimin për përmbarimin për ta bërë listën dhe shitjen e pasurisë së luajtshme nga banesa e të paditurit. Më 3 korrik 2007, gjykata e ka caktuar përmbarimin për 18 korrik 2007. Në këtë datë, gjyqtari ekzekutues ka shkuar në banesën e të paditurit por ekzekutimi nuk është kryer.

Në të dy shembujt, gjykatat kanë dështuar që menjëherë të fillojnë me propozimin e kreditorit për ekzekutimin e aktgjykimit. Në rastin e parë, procedura e ekzekutimit ka qenë në pritje për më shumë se gjashtë vite dhe në rastin e dytë për gati një vit. Kjo vonesë është kryesisht për shkak të mosveprimit të gjykatës. Duke mos i zbatuar vendimet e gjykatave në kohë të duhur, gjykatat jo vetëm se bëjnë shkelje të Ligjit mbi procedurën e përmbarimit por edhe të të drejtës për gjykim korrekt.¹⁴

Rrjedhimisht OSBE rekomandon që:

- Gjyqtarët ekzekutues menjëherë t'i procedojnë propozimet për përmbarim të ushtruara nga kreditorët, ashtu si kërkohet edhe me LPP.
- Avokatët duhet të kërkojnë që gjykatat t'i ekzekutojnë vendimet e klientëve të tyre në kohë të duhur.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të trajtojë gjyqtarët mbi Ligjin e procedurës përmbarimore.

vendimit më 10 gusht 2007, që ende nuk është shqyrtuar. Mos ekzekutimi (mos përmbarimi) i këtij aktgjykimi dhe paaftësia rezultuese e paditësit për ta gëzuar pasurinë e vet në mënyrë të qetë, mund të përbëjë edhe shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Shih *Loizidou v. Turqisë*, GJEDNJ aktgjykimi, i datës 18 dhjetor 1996, parag. 58-64 (duke gjetur se shtetit ka obligime pozitive për të siguruar se pronari i pasurisë të ketë qasje në të në mënyrë që të mund ta gëzojë. Shih *Qipro v. Turqisë*, GJEDNJ, aktgjykimi, 10 maj 2001, parag. 178-189.

¹⁴ Shënim: në të dyja rastet paditësit ishin të përfaqësuar nga avokatët të cilët kanë dështuar që me kohë të kërkojnë nga gjykatat që të procedohen propozimet e klientëve të tyre për përmbarim.